



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 8301 Prot.  
/2.3

Patos, më 26.04 / 2022

**PROCES-VERBAL**

I mbajtur sot në datë 21.04.2022 ora 10:00 në ambientet e Pallatit të Kulturës Patos organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupe interesi lidhur mbi marrjen e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-2023-2025"  
Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. ZV Kryetare e Këshillit Bashkiak
2. Sekretar i Këshillit
3. Kryetarë të fshatrave
4. Banorë të qytetit
5. Përfaqësues të ekzekutivit të Bashkisë

Takimi hapet nga Këshilltari Ervi Nënkyetarja e tKËshillit Bashkiak znj. Albiona Lamaj

Albiona Lamaj - në radhë të parë më lejoni t'ju falenderoj për pjesëmarijen tuaj në këtë fazë të parë të konsultimit për buxhetin afatmesëm 3-vjecar. Ne si këshill, kërkojmë prej jush të marrim sa më shumë informacion, mbi mendimin e komunitetit për përdorimin e fondeve publike të Bashkisë, por sigurisht edhe në ofrimin e shërbimeve cilësore prej saj, ndaj mendoj se mendmi juaj, rekomandimet apo sygjerimet, do të na shërbejnë ne si Këshill Bashkiak për të kanalizuar dhe përdorur fondet publike, atje ku është nevoja për tre vitet e ardhshme. Fjala është për ju.

Balil Balili- nënkyetarë përpëra se të fillojmë me marrjen e kërkesase mendoj që përfaqësuesi i financës të bëj një prezantim të investimeve të parashikuar për buxhetin e vitit 2022 për qytetin

Andi Kola ( Specialist i financës) – prezanton investimet e parashikuara për tu investuar në vitin 2022.

Balil Balili – të gjitha këto investime të cilat janë parashikuar për tu investuar përgjatë vitit 2022 kanë dalë si propozim i juaji në dëgjesat e realizuara në vitin 2021 dhe bashkia kërkesat tuaja i ka marrë parasysh duke i pasqyruar këto në buxhetin e vitit 2022. Jo pa paqëllim e përmenda këtë

fakt pasi rëndësia e realizimit të dëgjesave publike është tepër i rëndësishëm jo vetëm për faktin e marrjes së mendimit tuaj por edhe për të fituar besueshmërinë se në bashkinë tonë punohet.

Sejdin Shpërdheja – për cilën rrugë në Banaj bëhet fjalë se do të bëhet rikonstruksion?

Andi Kola – segmenti rrugor ka një gjatësi prej 820 ml dhe fillon nga rruga Camëria, kalon në bllokun nr3 te lagja e Re, në Lagjen Shpërdhe dhe Isufaj të fshatit Banaj dhe mbylljet në formë unaze me rrugën kryesore të Lagjes Vresht

Refat Ferataj – a është planifikuar rikonstruksioni i kanalizimit të ujrave të zeza në lagjen e re? Nëse jo kërkoj të planifikohet jo vetëm rikonstruksioni i saj por edhe vendosjen e tumbinave

Niko Golloshi – ( Kryetar i shoqatës së Invalidëve)- kërkoj që të parashikohet rikonstruksioni i segmentit rrugor Dukas – Qendër shëndetësore

Ajet Bregu ( Kryetar i fshattit Rusinjë) – në cilësinë e kryetarit të fshatit kërkoj të bëhet investime në rrugët e fshatit duke përfshirë edhe rrugën kryesore pasi në Rusinjë nuk është bërë investim dhe kjo është kërkesë e përsëritur.

Ilmi Myftaraj (Kryetar i fshatit Dukas) – është e vertetë që nuk është investuar në fshatin rusinj dhe dukhet të merret patjetër parasysh kjo kërkesë pasi invstimi në këtë rrugë do ti ndihmojë shumë banorët e fshatit por padyshim që ai segmet rrugor jep mundësinë e lidhjeve me fshatrat e tjera

Balil Balili – ju duhet të kuptoni se cdo reagim i juaji është një presion për ekzekutivin dhe Këshillin e Bashkisë.

Niko Golloshi – lidhur mbi ujësjellësin ju si këshill duhet të ushtroni presion për përshpejtimin e punimeve pasi cdo ditë po vidhen sahatet e vendosura në abonent

Balil Balili – investimi nuk ka përfunduar akoma dhe bashkia nuk mund të marrë në dorëzim një objekt të papërfunduar.

Albiona Lamaj – kjo është një fatkeqësi pasi jemi të gjithë ne që duhet të reagojmë në jë rast të tillë pasi është prona juaj dhe jo e bashkisë

Refat Shpërdheja ( Kryetari i fshatit Grizë) – kërkoj që për fshatin Grizë të ndërhyet në shtrimin e tre rrugës me asdfaltobeton të cilat ndodhen në hyrjen të lagjes prapa karburantit të PS-së dhe kanë lidhje direkt me rrugën kryesore si dhe të ndërhyet për sistemin e ndicimit rrugorë në fshat pasi distanca e tyre nuk shkon me shulmë se 500 ml dhe me një gjerësi 4 m.

Të ndërhyet për shtrimin e rrugëve për në parcelat e tokave bujqësore me zhavorr mali se cakull dhe kjo është një kërkesë e përsëritur. Gjithashtu nuk mund të lë pa përmendur faktin se fshati

jonë është pa kopësht duke qëfënë se objekti aktual doli jashtë funksionit dhe fëmijët parashkollar sot shkojnë në një ambient më qira dhe në kto kushte kërkoj që për fshatin Girizë në territorin e shkollës të ndërtohet një kopësht përfundimtar si dhe sistemimi i territorit në mënyrë kreative për tju shërbypet banorëve të fshatit.

Myustehak Resulaj - në lagjen e re kërkoj të ndërhyet përfundimtar

Balil Balili – rehabilitimi i zonës përreth përrojt në lagjene RE bashkia e ka projektin i cili fillon që nga përroi e deti te kthesa e Ballshit por është një investim kolosal i cili nuk mund të mbulohet dot nga buxheti i bashkisë dhe do të kërkohet bashkëfinancim apo donatorë.

Albiona Lamaj – ndonjë kërkesë tjetër?

Ilmi Myftaraj – do të ishte mirë që Kryetarja të na mblidhte të gjithë si kryetar fsahtash dhe të na prezantonte me drejtorat pasi nuk i njohim

Balil Balili – kjo kërkesë nuk i përket qëllimit përfundimtar të cilin jemi mbledhur por gjithsesi mbledhjete e Këshillit bëhen online dhe të hapura dhe jo vetem ju që jeni në cilësinë e Kryetarëve të fshatrave por cdo qytetar mund të ndeki nga afër vendimet që merr Këshilli.

Ndonjë kërkesë tjetër përfundimtar?

Albiona Lamaj – ne padishim që do të mbildhemi përsëri përfundimtar të diskutuar rreth buxhetit nësë nuk keu gjë tjetër përfundimtar të shtuar e deklaroj këtë takom të myllur

**Koordinator  
Për Konsultimin Publik  
Suzana Hysenaj**

